



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Seancë dëgjimore me Ministrinë e Brendshme (Gjendja Civile, Prefekturat, Çështjet Vendore)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Alket Hyseni dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Z. Sander Lleshaj - Minister

Zj. Vilma Causholli, Pergjegjese Sektori, Drejtorja e Pergjithshme e Buxhetit

Znj. Mimoza Dhembli – Drejtoreshe e Pergjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme jemi në ditën e tretë të zhvillimit të seancave dëgjimore në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2020.

Janë dëgjuar pothuajse të gjitha institucionet kushtetuese dhe të krijuara me ligj, por edhe ministritë e linjës, të cilat janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve dhe pjesë e nënkomisioneve që ka Komisioni i Ligjeve.

Sot kemi seancë dëgjimore me Ministrinë e Brendshme. Sa për sqarim të kolegëve, por edhe të të pranishmëve, në Komisionin e Ligjeve janë tre nënkomisione: Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, Nënkomisioni për Administratën Publike, si dhe Nënkomisioni për Pushtetin Vendor, të cilin e drejton zoti Fino.

Arsyeja që sot kemi në komision ministrin e Brendshëm, ka të bëjë me atë pjesë të buxhetit dhe me atë fushë të përgjegjësisë, që është në Komisionin e Ligjeve, e që lidhet me gjendjen civile, me prefekturat e me të gjitha çështjet vendore.

Gjithsesi, përfitojmë nga rasti që sot, nga Ministria e Brendshme, kemi prezent ministrin e Brendshëm, zotin Sandër Lleshaj.

Zoti Ministër, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Ministri i Brendshëm shoqërohet edhe nga zëvendësministri, zoti Hodaj, por edhe nga drejtori i Buxhetit pranë kësaj ministrie, zoti Hysaj, që do të flasin për gjithë projektbuxhetin e vitin 2020, për Ministrinë e Brendshme. Kuptohet, pa përfshirë këtu atë pjesë të buxhetit që lidhet me Policinë e Shtetit, për të cilën jam i bindur se është diskutuar në komisionin përkatës, në Komisionin e Sigurisë Publike.

Nga Ministria e Financave, si përherë kemi zotin Fran Brahimi, i cili mbulon çështjet vendore në këtë ministri.

Zoti Hysaj qesh, sepse ka vite që ka kaluar shumë buxhete së bashku me Franin, në këtë tryezë komisioni.

Relator do të jetë kolegu Bashkim Fino.

Pas kësaj seance dëgjimore do të kemi edhe miratimin nën nën të projektbuxhetit. Gjithsesi, pa humbur kohë, unë do t'ia kaloj fjalën ministrit të Brendshëm, zotit Sandër Lleshaj, për të bërë një prezantim në lidhje me nevojat buxhetore të Ministrisë së Brendshme, sa janë akomoduar këto nevoja buxhetore nga Ministria e Financave, në projektbuxhetin e vitit 2020, dhe çfarë mund të bëjmë ne, si Komisioni i Ligjeve, për t'ju mbështetur në Komisionin e Ekonomisë e më pas në seancë plenare, në lidhje me ato zëra buxhetorë ku ju keni nevojë.

Fjala për ju, zoti Ministër!

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë!

Faleminderit për mundësinë që na jepni, për të prezantuar projektbuxhetin e Ministrisë së Brendshme për vitin 2020. Ministria e Brendshme, sikundër tashmë duhet, ka pesë programe buxhetore kryesore. Është ai që ka të bëjë me Policinë e Shtetit, me Gardën e Republikës, planifikimin dhe menaxhimin, prefektura dhe funksionet e deleguara, nga të cilat, pjesën më të madhe e zë buxheti për Policinë e Shtetit, i cili zë rreth 80 % të vlerës totale. Sa u takon programeve të tjera, ato zënë diferencën prej 20 përqindësh.

Shkurtimisht, mund t'ju them dy fjalë lidhur me realizimin e buxhetit të 2019-ës, sepse në shumë aspekte, buxheti i 2020-ës është i bazuar dhe vijon ato programe të 2019-ës, po edhe të mëparshme.

Projektbuxheti i vitit 2019 ishte projektuar për 20, 7 miliardë lekë në total, për Ministrinë e Brendshme, ndërkohë që aty janë bërë ndryshime pozitive dhe ka përfunduar në vlerën 21 miliardë, duke u rritur me rreth 1 % gjatë vitit. Kjo tregon edhe vëmendjen e shtuar të qeverisë shqiptare në drejtim të mbështetjes së Ministrisë së Brendshme dhe të strukturave të saj, në plotësimin e misionit të tyre.

Me financim të brendshëm nga ky buxhet ka qenë 20, 2 miliardë, ose 96, 1 %, ndërkohë që 3, 9 % e këtij buxheti, ose 819 milionë kanë qenë financim i huaj, gjë që tregon se Ministria e Brendshme vazhdon të mbetet një institucion, i cili gjen mbështetje të rëndësishme nga partnerët tanë ndërkombëtarë apo nga donatorët, pra rreth 4 % e buxhetit, që nuk është pak.

Sipas programeve buxhetore, Policia e Shtetit ka pasur 16, 9 miliardë, ose 80, 3 % të buxhetit, garda e Republikës 1, 5 miliardë, ose 7, 5 % të buxhetit, planifikim-menaxhimi ka pasur 1, 3 miliardë, ose 6 %, prefekturat dhe funksionet e deleguara kanë pasur 607 milionë ose 3, 2 % të buxhetit total, ndërsa gjendja Civile ka pasur 678 milionë, ose 3 %. Deri tani, në total, buxheti është realizuar në vlerën 91 %, dhe pritshmëria është që, në fund të vitit, ky buxhet të realizohet në nivelin 100 %, gjë që flet edhe për një performancë të mirë të të gjitha institucioneve, që janë të angazhuara në ekzekutimin ose zbatimin e këtij buxheti.

Për të përmendur disa projekte të rëndësishme, të realizuara gjatë këtij viti, është përfundimi i komisarariatit special RENEA, një projekt i gjatë, i zhvilluar edhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me Bashkimin European, projekt i cili tashti është në përfundim, në vlerën 123 milionë, gjë që më në fund na mundëson të kemi një komisarariat të forcave speciale RENEA, në gjendje krejtësisht optimale dhe moderne.

Po kështu, ka ecur mirë projekti për ndërtimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, duke arritur në masën 70 %, me vlerë 205 milionë lekë, që po ashtu është po ashtu një investim i madh, i konsiderueshëm, në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës për strukturat e policisë së shtetit

Investimi i rëndësishëm për këtë vit ka qenë blerja e mjeteve të transportit, me bashkëfinancim me Bashkimin European, në vlerën 107 milionë lekë. Po kështu, është bërë një punë e madhe për të projektuar kompleksin e ri të Policisë së Shtetit, për korpusin e ri të Policisë së Shtetit, i cili do të ndërtohet aty ku është Akademia e Sigurisë, gjë që përbën edhe projektin më madhor të Ministrisë së Brendshme e të Policisë së Shtetit për vitet në vijim. Sivjet ka filluar puna për projektimin e këtij korpusi. Puna është në përfundim, dhe shpresojmë që vitin e ardhshëm të fillojmë me realizimin e këtij projekti, i cili do të jetë një ndër investimet më të rëndësishme e më serioze, të bëra në favor të Policisë së Shtetit. Kjo do ti japë Policisë së Shtetit, pra Drejtorisë së saj të Përgjithshme, Akademisë së Sigurisë dhe institucioneve të tjera, një fizionomi krejtësisht të re, bazuar në standardet më të mira europiane. Po kështu, këtë vit janë bërë investime në funksion të ndërtimit të bllokut të sigurisë e të dhomave të shoqërimit, në Drejtorinë e Policisë Tiranë, me një vlerë të konsiderueshme prej rreth 102 milionë lekë. Besoj se kjo shkon edhe në një linjë me interesin e me fushën e përgjegjësisë të komisionit tuaj, me të drejtat e njeriut, për të mundësuar që, edhe personat që shoqërohen apo ndalohen në dhomat e shoqërimit të Policisë së Shtetit, të

kenë kushte optimale, në përputhje me liritë e të drejtat që ata gëzojnë si qytetarët të Republikës së Shqipërisë.

Po ashtu, janë blerë armatime në një vlerë prej 100 milionë lekësh, pajisje për Policinë e Rendit, me një vlerë prej 151 milionë lekësh, pajisje për Policinë e Kufirit, në një vlerë prej 26 milionë lekësh, kryesisht lexues optikë të pasaportave.

Projektbuxheti i vitit 2020. Edhe në 2020-ën mbeten po të njëjtat programe kryesore: policia, garda, SHÇBA-ja, gjendjet civile, prefekturat e kështu me radhë.

Në fushën e Policisë së Shtetit, fokusi i buxhetit 2020 është rritja dhe intensifikimi i luftës kundër krimit të organizuar, luftë e cila do të njohë përmasa dhe intensitet krejtësisht të panjohur më parë në Shqipëri. Besoj se jeni në dijeni të faktit se, së shpejti, në Shqipëri do të përgatitet e do të miratohet edhe paketa përkatëse, e cila do t'i hapë mundësi të reja policisë dhe agjencie ligjzbatuese për ta intensifikuar luftën kundër krimit të organizuar, kështu që në favor të këtij prioriteti do të shkojë një pjesë e konsiderueshme e mbështetjes buxhetore të qeverisë

Po ashtu, fokus i rëndësishëm i punës së Policisë së Shtetit do të jetë edhe parandalimi i emigracionit të paligjshëm, kontrolli më i mirë i kufijve tanë, prioritet i cili shkon në linjë edhe me interesat e të gjithë partnerëve tanë ndërkombëtarë, kryesisht të Bashkimit Europian, me synim parandalimin, kontrollimin, bllokimin e flukseve të paligjshme migratore, të cilat lëvizin përmes Shqipërisë, por që origjinën e kanë nga vende të Lindjes së Mesme, si Siria e vende të tjera. Në interes të frenimit dhe kontrollit të këtij fluksi migrator, do të adresohen edhe fonde të konsiderueshme buxhetore nga ana e qeverisë shqiptare, por edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, kryesisht Bashkimi Europian.

Në funksion të Policisë së Shtetit do të vijojnë investime të rëndësishme në fusha të ndryshme, që do t'i përmend pak më poshtë.

Sa i përket Gardës së Republikës, pak a shumë ajo do të vijojë t'i ruajë ato parametra, me një rritje të lehtë, për shkak edhe të rritjeve të përgjegjësive të saj në sigurimin e personaliteteve që kanë të bëjë me sistemin e ri të drejtësisë: SPAK, BKH, prokurorët, gjyqtarët. Ligji parashikon që garda të ofrojë mbrojtje të veçantë ndaj tyre, ndaj për këtë arsye janë shtuar edhe disa investime në favor të Gardës së Republikës.

SHÇBA-ja mbetet po ashtu një nga strukturat prioritare këtë vit, ndryshe nga vitet e tjera, ajo do të marrë një përgjegjësi të re, të shtuar, sa i përket vetingut në Policinë e Shtetit, ose, për ta thënë korrekt: për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së

Republikës dhe SHÇBA-së. Ju e dini tashmë, se me ndryshimet e ligjit përkatës, që u bënë këtë vit, Komisioni i Jashtëm i Vetingut do të ketë për objekt vetëm drejtuesit e lartë të gardës, të SHÇBA-së dhe të Policisë së Shtetit, ndërkohë që për pjesën tjetër, të nivelit të mesëm dhe nivelit bazë zbatues, këtë funksion do ta kryejë SHÇBA-ja. Për këtë arsye SHÇBA-ja do të marrë vëmendje sa u takon investimeve, në mënyrë që të jetë në gjendje ta përballojë këtë mision të rëndësishëm

Ju e dini se tashmë vetingu në Policinë e Shtetit ka filluar, përmes Komisionit të Jashtëm. Po presim që nga gjysma e dytë e vitit të ardhshëm, këtë rol ta marrë përsipër SHÇBA-ja, e cila do të kryejë vetingun për pjesën e mbetur. Në këtë kuadër, investime do të bëhen edhe në infrastrukturë, edhe në pajisje, në teknologji, për arsye se pjesa e mbetur do të lidhet me angazhimin e teknologjisë në këtë proces. Përmendim këtu poligrafin dhe elementë të tjerë, të cilat do të futen si komponentë mbështetës, të cilët lehtësojnë punën e strukturave të vetingut.

Sipas tavaneve buxhetore për vitin 2020, mund të themi se Ministria e Brendshme ka marrë një rritje prej rreth 1, 4 %, referuar plan-buxhetit të vitit 2019. Është një rritje modeste, por gjithsesi është rritje. Sigurisht, do të donim të ishte më e lartë, por aktualisht kjo është çfarë është miratuar në qeverinë e Shqipërisë. Sigurisht, në dinamikën e vitit 2020 pritshmëria jonë është që kjo rritje të vijojë të thellohet, ashtu siç ka treguar edhe përvoja e viteve të mëparshme, që përgjithësisht buxheti i Ministrisë së Brendshme ka njohur rritje edhe gjatë vitit, kjo për arsye që lidhen me performancën e ekonomisë, me rritjen e ekonomisë e me faktorë të tjerë. Kësisoj, ne presim të kemi rritje më shumë se sa kjo, qoftë nëpërmjet instrumenteve tanë buxhetorë, qoftë nëpërmjet mbështetjes që marrim në mënyrë të vazhdueshme nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Në terma financiarë, me financim të brendshëm do të jenë rreth 20, 2 miliardë lekë, ose 96 % e buxhetit është me financim të brendshëm, ndërsa pjesa tjetër, 818 milionë, ose 3, 9 % e buxhetit, është me financim të huaj.

Sipas programeve kryesore, kemi këtë tablo:

Policia e Shtetit ka 17 miliardë, ose 80, 9 % të buxhetit, me një rritje prej 2 përqindësh në raport me vitin e kaluar; Garda e Republikës ka 1, 7 miliardë, ose 7, 9 % të buxhetit, me një rritje prej 6 % në raport me vitin e kaluar, rritje e cila i referohet faktit se është shtuar edhe përgjegjësia e gardës në raport me subjektet e reja që ajo ka marrë në ruajtje, që i përmenda më sipër; planifikim-buxhetimi ka 1, 1 miliardë, ose 5, 4 %, pra ka një ulje prej 8 % në krahasim me vitin e kaluar. Pra, ajo që është ulur këtu, është shtuar te garda, por siç e thashë, në total jemi në rritje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju them këtë. më thatë që të bëja një prezantim të plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dëgjoj kryetarin, sepse jam shumë hierarkik.

Ulsi Manja – Zoti Ministër, që të mos...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, le të fokusohemi tek...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sandër Lleshaj – Në qoftë se durimin tuaj e kam vënë në sfidë me këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jo, jo, absolutisht që ne kemi gjithë kohën e nevojshme në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sandër Lleshaj – Sa i përket gjendjes civile dhe prefekturave, po kështu kemi rritje respektive plus 1 % dhe plus 1, 3 %.

Pra, i vetmi program që ka pësuar ulje, është programi që menaxhohet nga ministria, programi i planifikim-menaxhimit, për t'ju dhënë një ide se ku e vëmë gërshërën. Ne e kemi vënë atje te vetja: kemi prerë buxhetin e ministrisë me minus 8 % në total, pra planifikim-menaxhim-administrimin, ndërkohë që kemi shtuar, sipas nevojave, projekt-programet kryesore, të cilat kanë nevojë për mbështetje të veçantë.

Sigurisht, pjesën më të madhe të buxhetit e merr personeli, 15, 7 miliardë, e kështu me radhë, shpenzimet e tjera, mallra, shërbime 3, 5 miliardë, investime 1 miliard, që mund të them se janë pak këtë vit, sipas këtij plani. Megjithatë, siç ju thashë, ne presim ndërhyrje të reja. Investimi i huaj është 819 milionë, i barabartë me vitin e kaluar.

Personeli zë 74, 4 % buxhetit. Është e madhe përqindja që merr personeli, por kjo është një situatë e krijuar tashmë, dhe do të kërkojë kohë të gjatë për ta zhvendosur balancën nga personeli tek shpenzimet e tjera apo te investimet. Disa nga gjërat konkrete te investimet, sepse besoj se kjo është themelore për një buxhet, ne parashikojmë që këtë vit të bëjmë projektin e mjediseve të reja të forcave të posaçme operationale. Ju e dini se tashmë kemi krijuar një strukturë të re brenda forcës së posaçme operationale. Kemi krijuar strukturën që merret me kërkimin dhe kapjen e personave që i janë shmangur drejtësisë. Disa i thonë FAST, por përkufizimi i saktë do të ishte: njësia që merret me kërkimin dhe kapjen e personave që i janë shmangur drejtësisë.

Duhet të dimë, të nderuar deputetë, që në harkun e tri dekadave është krijuar një numër i madh shtetasish shqiptarë, të cilët, megjithëse kanë marrë një dënim penal, nuk e kanë kryer atë për arsye se i janë shmangur dënimit. Ky numër është shumë i lartë, jo qindra, por janë mijëra të tillë.

Ky është një problem i madh i drejtësisë. Drejtësia e paekzekutuar është drejtësi e padhënë, prandaj Policia e Shteti dhe Ministria e Brendshme kanë marrë masa që ta adresojnë këtë çështje me seriozitet në mënyrë që të bëhen të gjitha përpjekjet, në mënyrë që të gjithë ata që kanë llogari të pashlyera me drejtësinë shqiptare, t'i shlyejnë llogaritë e tyre, pra të vuajnë dënimet përkatëse.

Ka persona që i janë shmangur dënimit penal dhe ka persona që i janë shmangur procedimit penal. Për të dyja këto kategori është ngritur kjo strukturë, e cila ka filluar të japë rezultatet e saj në kapjen e disa prej personave të shpallur në kërkim. Kjo strukturë do të fuqizohet, do të pajiset, do të modernizohet dhe do të bëhet pjesë e rrjetit europian të strukturave homologe, të cilat pastaj, së bashku merren me kërkimin e personave që i janë shmangur drejtësisë.

Këtë vit ne do të bëjmë edhe projektin për infrastrukturën e re ku do të vendoset kjo strukturë.

Sa u përket ndërtimeve, ne do të vazhdojmë të mbyllim, vitin e ardhshëm, drejtorinë vendore të policisë së Shkodrës, që është një investim madhor, rreth 25 milionë lekë të tjera, në vitin 2020.

Ndërkohë, do të vazhdojë projekti për mbylljen e dhomave të shoqërimit dhe mjediseve të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, që është rreth 142 milionë lekë të tjera në vazhdim nga viti i kaluar.

Këtë vit, në bashkëfinancim me BE-në do të ndërtohet edhe godina e pikës së kalimit kufitar në Qafë-Botë, e cila do të shtojë edhe një aset tjetër për menaxhimin më të mirë të flukseve të lëvizjes në kufirin tonë jugor.

Po kështu, një ndër gjërat themelore është një investim madhor që ne do të bëjmë në drejtim të Policisë Shkencore.

Shqipëria ka një institucion, Instituti i Policisë Shkencore, i cili në thelb është një laborator që duhet t'u shërbejë shumë klientëve, përveç policisë, pra shumë agjencive ligjzbatuese, si Policisë së Shtetit, Prokurorisë e të tjerë me ekspertizë dhe me analiza shkencore në funksion të procedimeve të ndryshme penale.

Për fat të keq ende nuk është bërë e mundur në harkun e këtyre tri dekadave që laborator i Policisë Shkencore të jetë në ato parametra që kërkohet. Sigurisht që në këtë laborator marrin rrugë të gjitha çështjet penale të vendit, marrin rrugë pozitive, por nganjëherë marrin edhe rrugë negative për arsye të parametrave të munguar të ekspertizës apo të teknologjisë së nevojshme.

Ky laborator konsiderohet si kyç për suksesin e përpjekjes sonë në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, prandaj duhet që patjetër këtë laborator ta çojmë në parametrat e kërkuar, pra të jetë një laborator i certifikuar dhe i akredituar në nivel ndërkombëtar.

Duhet ta ribëjmë këtë laborator nga e para në të gjitha aspektet, sepse kemi angazhimin e një vendi partner, aleat, i cili do të bëjë pjesën me të madhe të punës, pra ne do të bëjmë godinën, kurse ata do të merren me pajisjet, certifikimin, akreditimin, trajnimin e stafeve e të tjera me radhë, në mënyrë që të kemi një laborator të klasit botëror.

Po kështu, një projekt i rëndësishëm ka të bëjë me investime të tjera në fushën e ndërtimit të komisariateve të reja. Ne jemi në një proces të rëndësishëm që ka të bëjë me rishikimin e shpërndarjes së komisariateve të policisë. E dini se Shqipëria ka pësuar një migracion të brendshëm të madh, si dhe një emigracion, pra shumë njerëz kanë lëvizur ndërkohë që struktura e komisariateve ka mbetur ajo që ka qenë, prandaj ne po punojmë që të lëvizim komisarariatet drejt njerëzve. Sa për t'ju dhënë një shembull, në qoftë se Tirana ka pasur këto komisariate në vitet '90, këto ka edhe sot, ndërkohë që popullsia është shtuar me disafish dhe duhet të ndjekim po këtë tendencë që ndjek popullsia.

Po kështu, projekte të rëndësishme janë ato që lidhen me mjetet e transportit. Policia ka nevojë të lëvizë, kë nevojë për mjete transporti masivisht. Është bërë shumë edhe vitin e kaluar, edhe këto ditë do të kemi disa ngjarje publike për të prezantuar një teknikë të re që vjen në funksion të Policisë së Shtetit, por ky proces do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm, me qëllim që policia të jetë e pajisur me automjete moderne transporti dhe me mjete të tjera të nevojshme për plotësimin e funksionit të saj, kryesisht në drejtim të Policisë Kriminale, të Policisë Shkencore, të Policisë Kufitare dhe kështu me radhë.

Këto janë pak a shumë shinat në të cilat lëvizim në fushën e policisë.

Në pjesën që menaxhon Ministria e Brendshme, kemi bërë ulje dhe nuk kemi ndonjë risi për të raportuar në fushën e menaxhimit të madh, por ulja që është bërë te ministria është shtuar te programet e tjera që janë poshtë ministrisë.

Garda e Republikës do të ketë rritje në buxhet për arsyet që i parashtrova më lart dhe kryesisht këto janë për blerje të mjeteve të transportit, blerje të armatimit dhe të pajisjeve të reja, si dhe ka disa investime në fushën e lëndëve eksplozive, të lëndëve të dëmtimit në masë, pra janë disa investime, të cilat lidhen me natyrën specifike të punës së këtij institucioni të rëndësishëm që merret me ruajtjen e personaliteteve dhe institucioneve kushtetuese.

Sa i përket prefekturave, qeveria do të merret seriozisht me rritjen e rolit të prefekturave, si përfaqësuese të pushtetit qendror në nivel vendor. Prefekti si institucion duhet të njohë një fuqizim të rolit të tij, në aspektin e marrëdhënies me bashkitë, në aspektin e planifikimit të nevojave të këtyre bashkive për mbështetje qendrore, në aspektin e auditimit të këtyre njësive të pushtetit vendor, po ashtu prefekturat do të kenë një rol të rëndësishëm sa i përket koordinimit të degëve territoriale të pushtetit qendror, që janë të vendosura në qarqe dhe prefektura.

Në së shpejti do të keni edhe një propozim për ndërhyrje në disa vendime të qeverisë dhe në ligjin “Për prefektin”, në mënyrë që roli i prefektit të vijë duke u rritur dhe të jetë ai ndërmjetësi në raportet e qeverisë qendrore me pushtetin vendor. Po kështu, në nivelin e Ministrisë së Brendshme do të bëhen ndërhyrje të caktuara, ku disa funksione të cilat sot janë të shpërndara ndër ministritë e tjera, të kalohen te Ministria e Brendshme, me qëllim që vetë kjo ministri të luaj atë rol që i takon me ligj, rol i cili për shkaqe të ndryshme këto vite ka njohur një farë zbehjeje, por që në vitin 2020 do të ketë ridimensionim.

Sa u përket investimeve, nuk është se kemi parashikuar investime të mëdha në prefektura, por invensimet në prefektura do të bëhen në kuptimin ligjor, në kompetenca, attribute të reja që do t’u jepen prefektëve. Do të marrin vetëm një shtesë të vogël për pajisjet në mjediset e tyre të punës dhe do të vazhdojë puna për restaurimin e godinës së Prefekturës së Tiranës me një vlerë prej 40 milionë lekësh të reja për vitin 2020. Ideja është që i njëjti standard të aplikohet edhe në prefekturat e tjera.

Sa i përket Gjendjes Civile, kemi një investim modest, që ka të bëjë me pajisjet elektronike, për arsye se Gjendja Civile është një strukturë që i ofron shërbimet kryesisht online.

Pak a shumë këto ishin paratë që kemi në dispozicion.

Sa iu përket numrave, theksoj se në vitin 2020 shtohet Garda e Republikës me 27 persona, shtohet SHÇBA-ja me 31 persona, ndërkohë që janë bërë disa zvogëlime për disa struktura të tjera, të cilat janë larguar nga fusha e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme, si ç’ka qenë Komisioni për Verifikimin e Titujve të Pronësisë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave.

Pak a shumë kjo është gjendja.

A kemi nevojë për më shumë? Patjetër që kemi nevojë për më shumë, por këto nevoja ne i kemi diskutuar në qeveri dhe nëse ju keni mundësi të ndikoni që ne të marrim më shumë para, do të ishim të kënaqur, megjithatë ne jemi optimistë që buxheti që na është dhënë mundëson që Ministria e Brendshme ta kryej me sukses misionin e saj për vitin 2020.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër!

Pra, me sa kuptoj, projektbuxheti i vitit 2020 e garanton funksionalitetin normal të institucionit që ju drejtoni.

Zoti Fino si relator ka gjetjet e veta për këtë projektbuxhet lidhur me atë pjesë që na takon neve, gjendjet civile, prefekturat dhe çështjet vendore.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Falënderoj ministrin e brendshëm që është prezent këtu, zëvendësministrin, drejtorin e buxhetit dhe drejtorin e financës në Ministrinë e Financave!

Ekspozeja e ministrit ishte shumë e gjatë, shtrëuese do të thosha unë ose më mirë të themi si ato sportistët kur dalin për nxehtë në futboll, ata bëjnë nxehtë për të luajtur në ndeshje më fort. E thashë pak me humor këtë, sepse kjo nxehtë që ju bëtë është për të shkuar në orën 1:00 te Komisioni i Sigurisë.

Komisioni i Sigurisë është komisioni përgjegjës për të gjitha ato çfarë thatë ju, zoti Ministër këtu, të cilat kanë të bëjnë me planifikimin e menaxhimit të administrimit, kanë të bëjnë me Policinë e Shtetit, me Gardën e Republikës. Ne natyrisht i kemi shifrat, i kemi parë, por në mënyrë të detajuar është ai komision që diskuton këto çështje dhe bën propozime konkrete për Komisionin e Ekonomisë, i cili bën rifiniturën e fundit të buxhetit, pasi kalon në parim në datën 5 dhjetor e më pas do të kalojë nën për nën në datën 19.

Zoti Ministër, ne ju vlerësojmë dhe falënderojmë që ju erdhët vetë, se mund të dërgonit edhe zëvendësministrin që mbulon pushtetin vendor, mund të dërgonit edhe drejtorin e Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore apo drejtorin e buxhetit dhe përsëri niveli do të ishte shumë i lartë për të bërë një diskutim teknik dhe profesional për buxhetin.

Unë, duke e konsideruar pjesën tuaj si një pjesë shumë të rëndësishme, mbaj parasysh se në qeverisjen “Rama1” kemi pasur një ministër shteti për pushtetin vendor dhe unë kam pasur fatin e madh të jem kryetar i një komisioni që ka bërë një reformë shumë të rëndësishme, reformën e

ndarjes territoriale, një reformë të cilën edhe ju në strukturat tuaja si Ministri e Brendshme po e shtrini dhe po e detajoni strukturën tuaj brenda kësaj reforme të re territoriale. Sot ne nuk kemi një ministër shteti, por ne kemi një ministër të brendshëm që nuk mbulon vetëm problemet e policisë, por mbulon në kompleksitetin e tij gjithë kuptimin që ka fjala “ministër i brendshëm”, pra edhe elemente të prefekturës, të shërbimit, të emergjencave, të menaxhimit të rezervave e të tjera dhe duke qenë se pjesa kryesore e kësaj ministrie është policia dhe një pjesë e saj është garda.

Unë do të flisja, zoti kryetar, më shumë për këto dy elemente që kanë të bëjnë me pjesën tonë. Ne kemi pasur dje një dëgjese me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, që është edhe kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, kemi bërë takime të ndryshme edhe me agjencinë tuaj. Komisioni ynë ka pasur rastin që para 10-15 ditëve të bëjë një takim te Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe nuk e kemi bërë pa qëllim këtë takim dhe gjej rastin të falënderoj gjithë anëtarët e komisionit që erdhën të gjithë pa përjashtim, vetëm e vetëm për të parë se si ecën kjo agjenci, që ju keni në varësinë tuaj si ministri në kuadrin e të gjithë reformës, jo vetëm territoriale, por edhe të decentralizimit të pushtetit vendor. Është një reformë e rëndësishme dhe unë mendoj se jo vetëm drejtoria e agjencisë, por edhe ju që jeni përfaqësues i qeverisë duhet të jeni një avokat i devotshëm i organeve të pushtetit vendor, në rastin konkret duke e mbuluar këtë pjesë të pushtetit vendor.

Ajo që dua të them me shifra është korrekte, ju keni vërtet një rritje të buxhetit. E thatë edhe vetë që funksionaliteti i Ministrisë së Brendshme është “OK” me shifrat që keni. Po kështu jo vetëm për pjesën e Policisë, pjesën e Gardës, por edhe për efekt të funksioneve të deleguara shifrat janë korrekte dhe në rritje. Po kështu janë për shërbimet dhe gjendjen civile që janë shërbime të deleguara, të cilat bëhen pranë organeve të pushtetit vendor, por që vartësinë financiare e kanë ndaj jush si Ministri e Brendshme.

Kam një pyetje më tepër për drejtorin e buxhetit, sesa për ju, sepse ju jeni person politik dhe nuk merreni me shifrat në kuptimin e mirë të fjalës, ndërsa ne që jemi këtu kemi kohë të tepërt që të merremi edhe me politikë, por edhe me shifra. Është fjala për efektet dhe funksionet e deleguara të prefektëve që në investimet e vitit 2019 kanë pasur rreth 264,6 milionë lekë, është një shifër e konsiderueshme që keni marrë për prefektët. Në fakt, me shifrat që kam nga Ministria e Financave realizimi i investimeve vetëm në fund të muajit tetor, pra të 10- muajit, kur duhen edhe 2 muaj që të mbyllet viti, është realizuar 65. 264 milionë me 65. Pra, 200 milionë ngelen tepër. Këto 200 milionë nuk mund të harxhohen dot për dy muaj. Absolutisht jo. Fakti që qeveria

dhe Ministria e Financave kanë planifikuar për vitin 2020 vetëm 45 milionë investime për prefekturat tregon që kjo lloj performance e këtyre investimeve nuk është realizuar, ose janë në proces dhe një pjesë, një përqindje e mirë e investimeve do të mbyllet në këto prefektura gjatë këtyre dy muajve. Kur jepen fondet është gjë e mirë, por duhet edhe të realizohen zoti Ministër. Këtë e kam politike për ju, sepse zakonisht në fund të vitit këto fonde digjen, nuk mund të trashëgohen për vitin tjetër dhe nuk ka pse të trajtohen në këtë mënyrë.

Përveç kësaj do të thosha se ka ardhur koha që Agjencia për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore të ju duhet të ketë një koordinim më të mirë edhe me ne si deputetë dhe Nënkomision për Pushtetin Vendor edhe me shoqatat e bashkive të Shqipërisë, edhe me prefektët që janë në varësinë tuaj, që janë direkt siç thatë ju.

Më pëlqeu referenca juaj, pjesa e fundit, ku trajtuat disa çështje. Ato do t'i marr si udhërrëfyes për vitin 2020, për fuqizimin e prefektit, për detyrat që ka prefekti, për idenë që keni për të bërë një ligj të ri për prefektët, për t'i fuqizuar ata dhe për të qenë në avantgard, në kuptimin që të jenë vërtetë përfaqësuesit e qeverisë pranë pushtetit vendor në zonat përkatëse.

Çështjen e trajtimit në ligj, do ta shikojmë hap pas hapi edhe në kuadër të bashkëpunimit me Kartën e Autonomisë Vendore, që të mos kemi përplasje midis pushtetit vendor dhe atij qendror. Ato që janë kompetenca të prefektit janë të prefektit, ato të pushtetit vendor, janë të tyre dhe nuk mund të kemi ndërhyrje. Instrumentet ligjore mund t'i gjejmë dhe mund ta rrisim rolin e prefektit.

Unë jam një njeri që kam punuar në pushtetin vendor, kam punuar edhe në pushtetin qendror dhe e di se si ka evoluar trajektorja e prefektëve. Dikur kemi pasur një ligj shumë të fortë për prefektët, në momentin kur e kemi krijuar. Kjo trajektore ka ardhur në rënie, për hir të së vërtetës, po të kemi parasysh sot prefektët kanë një fuqi ligjore shumë herë më të paktë sesa e kanë pasur më parë. Ndoshta ka ardhur koha që ne ta rrisim këtë trajektore dhe të bëjmë një prefekt më të zotë dhe më të fortë nga pikëpamja ligjore që të ketë disa gjëra direkte. Ju e dini shumë mirë që ka drejtori të drejtuara vertikalisht, por ka edhe të tilla të drejtuara horizontalisht, të cilat ngandonjëherë i përgjigjen prefektit thjesht për kulturë, por në vartësinë e tyre të drejtpërdrejtë mund të ketë edhe mungesë respekti, mund të mos kthejnë as përgjigje dhe as të kenë marrëdhënie midis tyre, ndërkohë që prefekti përkufizohet si një përfaqësues i Kryeministrit në një rajon të caktuar. I thashë të gjitha këto dhe shumë elemente që kanë organet e pushtetit vendor që i diskutuam dje me kolegët. Pushteti vendor ka një ligj për financat

vendore, i cili është shumë i rëndësishëm dhe duhet të respektohet, që do të thotë se granti i pakushtëzuar nuk duhet të zbresë nga 1% e GDP-së së buxhetit. Kjo është e padiskutuar, këtë gjë duhet ta kërkojë edhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, që është një agjenci serioze dhe duhet të ishte sot këtu për të diskutuar, duhet të ishte edhe dje që ishin shoqatat e kryetarëve të bashkive për këtë problem, pasi është një agjenci që e kemi krijuar rishtazi para 2-3 vjetësh me koshiençë në funksion të ndarjes territoriale se si do të funksionojë dhe si do të implementohet ky ligj i ri. Nga kjo pikëpamje, organet e pushtetit vendor kanë borxhe, të cilat duhet të trajtohen me kujdes me Ministrinë e Financave apo dhe me këtë agjenci, ashtu siç ka edhe kërkesa të ndryshme qoftë të rentës minerare që kanë organet e pushtetit vendor, atje ku nxirret minerali, apo aty ku ka porte, aeroporte duhet të marrin më shumë të ardhura. Në ligjin e ri e kemi që 5% të tyre duhet ta marrin organet e pushtetit vendor. Kërkohet që të rritet akoma edhe më shumë për të marrë më tepër të ardhura pushtetit vendor apo edhe situata të tjera, të cilat ne i kemi diskutuar gjerë e gjatë.

I thashë të gjitha këto për të hapur një trajektore diskutimi më tepër për të parë se Ministria e Brendshme ka shumë punë, në kuptimin e legjislacionit, të kuadrit të decentralizimit të pushtetit vendor apo dhe të gjithë problematikës që kanë. Sa më mirë ta njohim gjendjen e pushtetit vendor, aq më mirë duhet ta bëjmë ligjin për prefekturat dhe nuk do të kemi përplasje.

Ju thatë një fjali: “Ka shumë funksione të shpërndara, të cilat janë në ministrinë e tjera dhe duhet të vijnë në Ministrinë e Brendshme”. Unë jam dakord, sepse jeni ministri i Brendshëm që përfaqësoni edhe organet e pushtetit vendor, në njëfarë mënyre prefektin në qeveri, por duhet të jemi të kujdesshëm në disa pika. Duhet t’i marrim gjërat pranë Ministrisë së Brendshme dhe t’i trajtojmë në kuadrin e decentralizimit, por të mos tejkalojmë disa gjëra, të cilat nesër mund të na bien bumerang, për shembull nëse një drejtori finance është në Ministrinë e Financave dhe atje është burimi financiar për organet e pushtetit vendor apo për prefekturat, do të ishte mirë të qëndronte atje, sepse i kemi mundësitë më shumë për të marrë fonde.

Ju e kuptoni shumë mirë se jeni ministër, edhe unë po aq mirë sa ju se çfarë do të thotë, ashtu siç është pushteti vendor në luftë “të papajtueshme” me pushtetin qendror për të marrë më tepër kompetenca ashtu janë edhe ministrat e tjerë në luftë “të papajtueshme” me Ministrinë e Financave për të marrë sa më tepër fonde.

Ju e mbyllët fjalën tuaj se funksionaliteti i kësaj ministrie me këto fonde që ka në vitin 2020 është korrekt dhe jeni shumë i kënaqur, apo jo? “Por nëse mund të ketë më shumë fonde,

unë jam dakord, por përsëri më jepni, unë do t'i marr". Këtë e shikoj tek akti normativ i vitit 2019, atë që thatë dhe ju më parë se nëse në projektbuxhetin e vitit 2019 ju kishit më pak, po marr Policinë e Shtetit, meqenëse atë keni pjesën kryesore ju: 12 miliardë e 0,72 milionë lekë, me aktin normativ që qeveria dhe parlamenti ju kanë mbështetur, e rriti atë në 12 miliardë e 326 milionë. Pra, ju dha mundësinë edhe për më shumë. Të gjitha këto kanë të bëjnë me atë që duhet të merremi pak më tepër edhe me problemet që kanë të bëjnë me organet e pushtetit vendor, me prefekturën, me gjendjen civile. Janë dy degë që zënë një përqindje shumë të vogël në buxhetin e ministrisë suaj në raport me Policinë apo me Gardën, por janë dy nga elementet kryesore të funksionit të ministrisë suaj, të cilat duhet t'i shikojmë më me përparësi dhe me më shumë dashuri për të arritur dhe për të realizuar edhe ndryshimet ligjore, por edhe të ndihmojmë të kemi sa më shumë fonde për prefektët apo për shërbimin e gjendjes civile.

Zoti kryetar, unë këto kisha në tërësi, sepse shifrat janë të kënaqshme, vetë buxheti është mbi 1,4 % më i lartë nga viti tjetër në tërësinë e tij, po kështu edhe këto dy elemente që mbulojmë ne: prefekturat dhe shërbimi i gjendjes civile.

Bëra më tepër një diskutim teorik, për të pasur në të ardhmen një bashkëpunim më tepër me Agjencinë e Mbështetjes apo me zëvendësministrin që mbulon pushtetin vendor në Ministrinë e Brendshme. Mbështetjen e ministrit e kemi.

Ju falënderoj që jeni sot këtu! Nuk po hyj në gjëra konkrete, ndonjë gjë për t'u diskutuar, sepse rritja e shifrave është konstate, dhe në rritje për vitin 2020.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Fino!

Kush ka ndonjë gjë për të shtuar?

Ju lutem shumë shkurt, sepse ministri në orën 12:00 duhet të jetë në një komision tjetër të Kuvendit për t'u dëgjuar për projektbuxhetin e vitit 2020!

Po, zonja Hysi, siç duket ka ndonjë merak për projektbuxhetin e ministrisë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër për ekspozenë e gjerë që bëtë për projektbuxhetin e vitit 2020!

Ndoqa me vëmendje dy informacione që dhatë në lidhje me shërbimin e gjendjes civile dhe me dhomat e sigurisë në rajonin e Tiranës. Unë kam një pyetje lidhur me komisaritet, jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.

E para, lidhur me detyrimet që ka ministria juaj për të përshtatur mjedise të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin, detyrim që buron në kuadër të Kodit të Drejtësisë për të Mitur të miratuar gjatë reformës në drejtësi. Njëkohësisht CPT-ja në raportin e fundit ka vënë në pah dhe ka kërkuar që të gjitha komisariatet të përshtatin mjedise të përshtatshme. Pyetja është: ky buxhet që përmendët do ta përmbushë këtë kërkesë dhe detyrim ligjor që kemi?

E dyta, vjet Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar disa ndryshime në ligjin për parandalimin e dhunës në familje, ku kemi futur një element shumë të ri dhe kemi rritur përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit lidhur me trajtimin e viktimës dhe krijimin e një mjedisi miqësor për viktimat. Pra, do të thotë që në komisariatet e policisë duhet të ketë një mjedis për pyetjen, intervistimin e viktimave, ofrimin e shërbimeve urgjente derisa të bëhet referimi tek institucionet përkatëse. Në buxhetin që thoni, ku përmendët shumë elementin e sigurisë për personat, unë si kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut do të shikoja edhe të drejtat e viktimave, a e përmbush këtë kërkesë, këtë detyrim?

Do të doja të sillja në vëmendje që në vitin 2020 GREVIO, mekanizmi monitorues i Konventës së Stambollit, do ta monitorojë këtë element që lidhet me trajtimin e viktimave të dhunës në familje.

Kam një pyetje për punonjësit e Policisë së Shteti. Të gjithë jemi dëshmitarë që ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë përballuar situata të vështira, orar pa orar.

Nga ana tjetër ka edhe një Kod, ku kanë të drejtat e tyre. Ne i kemi besuar sigurinë, jetën, rendin, por sa u mundëson ky buxhet mbulimin e punës jashtë orarit, shpërblimet dhe vështirësitë? Flasim për të drejta të qytetarëve, në radhë të parë këta janë qytetarë, të cilët duhet të kenë garancitë, respektimin e të drejtave të tyre që të na shërbejnë edhe ne. Ky buxhet, pikërisht te pasqyra që është paraqitur, a i mbulon detyrimet që kemi, por edhe punën?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Ministër, një përgjigje për shqetësimet që ngriti zonja Hysi.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Sigurisht, që janë pyetje me rëndësi. Për pyetjen që shtruat lidhur me kushtet e përshtatshme për trajtimin e fëmijëve, që duhet të paraqiten në komisariatet e policisë, është një projekt që prej kohësh po zbatohet në vendin tonë në bashkëpunim edhe me partnerët e BE-së, konkretisht me Suedinë, i cili e adreson këtë çështje për fëmijët dhe për gratë.

Gjatë vitit 2019 janë bërë disa investime të tilla në komisaritet e policisë, ku janë krijuar mjedise të përshtatshme sipas standardeve më të mira suedeze, sepse sipas praktikës së tyre është realizuar projekti. Ky projekt do të vazhdojë edhe në vitin 2020.

Para disa ditësh kam pritur ambasadorin e re të Suedisë dhe është konfirmuar vijimi i këtij projekti, i cili do të na mundësojë në ta zgjerojmë numrin e komisariateve ku janë krijuar kushte të mirëfillta dhe të përshtatshme për një trajtim dinjitoz, human të fëmijëve apo të grave që për arsye të ndryshme detyrohen të trokasin në dyert e komisariateve të Policisë së Shtetit.

Për pyetjen në lidhje me trajtimin e Policisë së Shtetit, së pari ju falënderoj, sepse më jep mundësinë ta ritheksoj edhe një herë nevojën që kemi të gjithë për të trajtuar, për të mbështetur Policinë e Shtetit në të gjitha aspektet, si në atë financiar, ligjor, publik, sepse Policia e Shtetit është një instrument, i cili i shërben të gjithë publikut, të gjithë qytetarëve dhe përballon një pjesë të madhe të problematikës së këtij vendi. Është bërë aq sa ka qenë e mundur për t'u bërë, është bërë shumë në drejtim të përmirësimit të kushteve.

Për punonjësit e Policisë së Shtetit në vitin 2020 e reja është se ne do t'i kufizojmë, shpresojmë ndjeshëm orët shtesë. Nuk do të tentojmë t'i paguajmë orë shtesë, por do të tentojmë të mos bëjnë orë shtesë, duke shtuar numrin e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për këtë do të paraqesim së shpejti në parlament një projektligj, i cili ka 2 qëllime. Së pari, një numër i caktuar i punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë arritur një moshë apo një kondicion fizik të tillë, që nuk u mundëson shërbim normal, të mund të dalin nga Policia e Shtetit në një formë pensioni të parakohshëm, por një pension, i cili do t'u mundësojë pak a shumë trajtimi financiar afërsisht të njëjtë me atë që kanë pasur kur ishin me shërbim, që të mos krijojmë një traumë, ndërkohë vendet që lirohen prej këtyre të plotësohen me djem dhe vajza të reja që kanë kushte, mundësi për ta kryer shërbimin më mirë. Do të shtojmë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ne kemi bërë një llogari, afërsisht paguajmë orë shtesë sa rrogat e 600-700 punonjësve të policisë. Pra, do të shtojmë punonjësit e policisë, me qëllim që të mos bëjnë orë shtesë, por të bëjnë orë normale. Të kemi 500-700 punonjës policie më tepër në mënyrë që askush të mos detyrohet të bëjë orë shtesë, sepse orët shtesë edhe po i paguam nuk është një punë e kryer në kushte normale dhe duhet ta eliminojmë këtë gjë sa më tepër. Sigurisht ne jemi ende vendi me policinë më të vogël në të gjithë Europën Jugore. Nëse duam të shkojmë në parametra mesatarë të numrit të policëve për frymë, ashtu si edhe shumë vende të tjera të rajonit si: Italia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi e me radhë, duhet që Policia e Shtetit shqiptar të ketë mbi 20

mijë vetë. Sot kemi 11 mijë. Ju duhet ta kuptoni se çfarë deficiti të madh kemi në njerëz në raport me Policinë e Shtetit krahasuar me vende të tjera të BE-së, apo vende të tjera të rajonit. Në kuadër të Strategjisë së Policisë së Shtetit, e cila është miratuar në këtë Kuvend para dy vjetësh, duhet të shtojmë numrin e Policisë së Shtetit dhe po e vazhdojmë këtë punë në mënyrë konsekuente. Pra, të shtojmë numrin, të rinovojmë Policinë e Shtetit, të heqim mundësinë për orë shtesë dhe të mendojmë për trajtime të tilla preferenciale, siç janë pagat, shpërblimet. Besoj se në vitin 2020 edhe çështja e uniformës do të marrë rrugë të qëndrueshme. Ne po e ndryshojmë sistemin e furnizimit. Sistemi i furnizimit nuk do të jetë më të shkosh në depo, por duhet të marrësh lekët dhe më pas ta blesh atë në një subjekt të licencuar, në mënyrë që të garantohet vijueshmëria e furnizimit të uniformës dhe të mos jetë më plaga e mospajisjes me uniformë, gjë që nuk mund të tolerohet më. Ne jemi të vendosur që në vitin 2020 kjo çështje të marrë fund. Procedurat janë në zhvillim e sipër dhe shpresoj që shumës shpejt edhe kjo çështje do të largohet nga axhenda.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Alimadhi, shkurt se ministri do të largohet.

Adriatik Alimadhi – Shyqyr që kemi ministrin e Brendshëm dhe është për t’u vlerësuar, pasi është një nga institucionet që e vlerëson Komisionin e Ligjeve. Nëse është e mundur kam dy pyetje, zoti Ministër? Në fakt, shikojmë shpeshherë që ka detyrime të vendimeve gjyqësore të oficerëve të liruar, por në mënyrë të padrejtë, përderisa kanë fituar të drejtën. A ka detyrime për t’u kthyer këtyre dhe a ka lekë për t’ua kthyer?

Së dyti, në fakt, ju jeni përballur me një sërë protestash për shkak të situatës politike, por, sigurisht, ishte një vit zgjedhësh. Shpeshherë, shikojmë punonjës policie që ankohen për orët shtesë ose për orët natës. A ka vend për t’u trajtuar kjo? Pse nuk i kanë marrë detyrimet?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Së pari, për çështje që kanë të bëjnë me vendime gjyqësore në favor të punonjësve të caktuar të policisë, mund t’ju them se ato janë trajtuar brenda kuadrit ligjor. Duhet të keni parasysh që ligji për Policinë e Shtetit e ndalon rikthimin në polici të personave që kanë 2 vjet që janë shkëputur prej saj, pavarësisht kushteve. Kështu që kjo ka krijuar vështirësi. Në komision është

diskutuar mundësia për të gjetur një hapësirë ligjore, por kemi një barrierë që nuk lejon rikthimin në polici të punonjësve, të cilët kanë dy vjet pavarësisht vendimit.

(Diskutime pa mikrofon)

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, sigurisht kanë buxhet dhe i rimbursen detyrimet e caktuara gjyqësore, por për rikthimin në polici është barriera ligjore.

(Diskutime pa mikrofon)

Ndërsa detyrimet e prapambetura janë parashikuar në buxhetin e këtij viti. Ndërsa për sa u përket orëve shtesë e dhashë përgjigjen. Viti i kaluar ishte super i ngarkuar për Policinë e Shtetit; e para, është menduar që të reduktohet nevoja për të bërë orë shtesë dhe, e dyta, aty ku është e pashmangshme orët shtesë të paguhen. Nuk kemi orë të papaguara. Qeveria ka marrë masa që orët shtesë të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë këtij viti janë të paguara. Nuk kemi deficite në raport me punonjësit tanë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër!

Një merak të fundit ka zonja Hysi dhe e mbyllim.

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti Ministër, te ligji për gjendjen civile ne kemi bërë një ndryshim në lidhje me regjistrimin e fëmijëve pa shtetësi. Në këtë kuadër, kemi përcaktuar që për fëmijët pa shtetësi, në bazë të ligjit për ndihmën juridike, do të bëhet ekzaminimi i ADN-së dhe për ato familje që nuk kanë mundësi kjo do të paguhet. Në kuadër të investimeve për laboratorin shkencor, që unë ju përshëndes shumë që do ta ribëni, a është llogaritur që do të mbulohen edhe këto lloj ekzaminimesh që janë realisht të shtrenjta, pra analiza e ADN-së?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Ministër!

Sandër Lleshaj – Nuk mund t'ju kthej përgjigje për këtë, jam i papërgatitur të jap një përgjigje, se është shumë konkrete.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ministër, për përgjigjet!

Nga kjo seancë dëgjimore me ministrin e Brendshëm u evidentuan problematika që kanë të bëjnë me nevojat buxhetore të vitit 2020. Ashtu siç tha ministri, por edhe kolegu Fino si relator, projektbuxheti i vitit 2020 siguron funksionalitetin normal të organit që drejton zoti Lleshaj, pra të Ministrisë së Brendshme. Nuk ka problematika buxhetore në lidhje me gjendjen civile, me prefekturat, në përgjithësi për të gjitha çështjet vendore. Kështu që unë dua ta falënderoj ministrin për prezencën sot në komision! Po ashtu, dua të falënderoj edhe kolegët për durimin në këtë

dëgjuesë dhe t'i japim leje ministrit që të shkojë te komisioni përgjegjës për të raportuar për nevojat dhe problemet buxhetore që ka Policia e Shtetit.

Faleminderit, zoti Ministër, zoti Hodaj dhe zoti Hysi!

Ditë të mbarë!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Për procedurë, meqenëse ka edhe deputetë që nuk kanë qenë këtu, edhe ne kemi bërë një punë të jashtëzakonshëm.

Meqenëse pika e dytë është shqyrtimi nen për nen, kërkoj një gjysmë ore pushim; mbledhja të fillojë në orën 12:30.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Në fakt, neve na është servitur një material përmbledhës nga relatori, zoti Fino, për të cilin kam respekt, por mendoj se ky është i përfunduar tërësisht. Mendoj se ne duhet të nxirrnim disa konkluzione, nuk e di pse zoti Fino e ka bërë gati para se...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, si relator, kërkoj 30 minuta pushim. Relacioni që keni përpara është opinionimi i relatorit, i cili do të prezantohet në komision dhe kolegët deputetë kanë të drejtën të bëjnë sugjerime dhe shtesa për raportin.

Unë jam dakord me kërkesën e zotit Fino për 30 minuta pushim. Mbledhja e komisionit rifillon në 12:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi nën për nën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” dhe miratimi i raportit të komisionit për Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Zj. Vilma Causholli, Përgjegjese Sektori, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

Znj. Mimoza Dhembli – Drejtoreshë e Përgjithshme

Ulsi Manja – Atëherë le të hyjnë mediet, në qoftë se janë, për efekt të transparencës.

Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar pikën e dytë të rendit të ditës, ku kemi shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” dhe miratimin e raportit të komisionit. Jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Bashkim Fino. I kemi përfunduar sot dëgjesat për pikën e parë të rendit të ditës, seancën dëgjimore me Ministrinë e Brendshme, që ishte institucioni i fundit që u dëgjua në komision për projektbuxhetin e vitit 2020. Në këto 4 ditë në Komisionin e Ligjeve janë dëgjuar jo pak, por 20 institucione kushtetuese dhe të krijuara me ligj, por jo vetëm, që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve.

Kolegu Bashkim Fino, si relator, ka bërë relacionin përkatës për projektbuxhetin e vitit 2020. Janë marrë nevojat buxhetore për vitin 2020 institucion për institucion, çfarë është akomoduar nga Ministria e Financave dhe çfarë kemi miratuar ne si komision paraprakisht gjatë dëgjesave për secilin nga institucionet. Gjithsesi, unë, zoti Fino, propozoj që të vazhdojmë me prezantimin e raportit që ju keni hartuar dhe që kolegët e mi të komisionit e kanë mbi tryezë, më pas ta votojmë raportin e relatorit. Shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të vitit 2020 do t’i bashkëngjitet edhe raporti përkatës që do t’i përcillet pastaj Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës. A jeni dakord me këtë procedurë, zoti Fino? Dakord.

Atëherë, ia kaloj fjalën kolegut Fino të bëjë prezantimin e raportit që ai ka hartuar në këtë fazë për projektbuxhetin e vitit 2020.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Zoti kryetar, ne kemi operuar gjatë këtyre 4 ditëve, duke e diskutuar çdo institucion më vete, duke dëgjuar pretendimet e tyre, duke i ballafaquar ato me Ministrinë e Financës dhe në fund të çdo institucioni ju keni votuar. Pra, le të themi se këtë relacion që unë kam bërë ma keni bërë më të thjeshtë ju, sepse kam pasqyruar kërkesat e tyre dhe atë çfarë është votuar gjatë këtyre 4 ditëve nga ana e komisionit për çdo institucion që është rënë dakord me Ministrinë e Financave. Domethënë, çdo institucion që ne kemi këtu e kalojmë edhe një herë. Me *bold* keni atë çfarë ne kemi miratuar si komision dhe kemi rënë dakord me Ministrinë e Financave. Pjesa tjetër është pjesa e kërkesave. Shumica e këtyre institucioneve, me thënë të drejtën, kanë qenë të kënaqura me projektbuxhetin dhe nuk kanë kërkuar ndonjë gjë. Pasi kalon ky raport, atëherë ju jeni të detyruar t’i kaloni të 21 nenet e projektbuxhetit të vitit, sepse ky relacion atashohet dhe ngjitet në bazë të neneve dhe pasqyrave përkatëse që ka projektbuxheti. Domethënë, do të kalojmë nenin 1 “Të

ardhurat dhe shpenzimet”, natyrisht, aty do të ketë ndryshime, në qoftë se ky relacion është funksional; dhe bëhet funksional te Komisioni i Ekonomisë dhe ndryshon. Për shembull, do të kalojmë nën 15 “Shpenzimet e pushtetit vendor”. Pikërisht ajo ka të bëjë me këtë gjë.

Pa humbur kohë, kolegët ndaj e lamë dhe atë gjysmë ore pushim, relacionin e kanë përpara. Unë nuk dua të flas për çdo institucion, sepse është e tepërt, se ju e keni përpara, por, në qoftë se ka ndonjë pyetje ose ndonjë sugjerim nga kolegët, ata që kanë qenë prezentë këtu, por edhe ata që nuk kanë qenë prezentë, për të bërë ndonjë pyetje pse keni arritur në këtë konkluzion, ose pse nuk kemi mundësi për të bërë ndonjë gjë tjetër, jam i gatshëm të dëgjoj, që të mos i marrim një nga një për të diskutuar, sepse i kemi diskutuar një herë, zoti kryetar, kur kanë kaluar këtu. Jam i hapur për të kthyer përgjigje, aq sa kam mundësi, sepse mund të jenë pyetje të vështira dhe e kam të pamundur të kthej përgjigje, por do të mundohem. Kështu që fjala është për ju për materialin në tërësi dhe për ta kaluar të gjithë relacion në tërësi më pas.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Bushka e ka kërkuar fjalën dhe më pas zonja Hysi.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Fino, për këtë punë të bërë kaq mirë!

Në fakt, është shumë e thjeshtë për ne të tjerët në Komisionin e Ligjeve të shqyrtojmë projektligjin e buxhetit dhe çështjet që lidhen me të, kur ju jeni relator, sepse i bëni të qarta edhe për ne që nuk kemi njohuri në këtë fushë. Ju përgëzoj për raportin. Unë e lexova; është shumë i qartë, shumë i thjeshtë edhe për atë që nuk është ekonomist apo financier që ta kuptojë. Kështu që përgëzime për punën! Unë kam vetëm dy pyetje. Njëra ka të bëjë me reformën në drejtësi. Ne vjet kemi pasur një nen të dedikuar në projektligjin e buxhetit të shtetit për reformën në drejtësi. Nuk e shikoj që të jetë këtë vit në projektligj. E lexova në raport; tashmë jemi para faktit që janë ngritur institucionet e reja të drejtësisë dhe ka secili buxhetin e tij dhe pa diskutim që janë të detajuara, por thjesht është një pyetje për ta kuptuar. Ai që ishte vjet si një fond i madh i përcaktuar dhe më pas do të detajohej gjatë vitit tani është e mbartur, se nuk janë harxhuar të gjitha paratë e vjetshme? Pra, a kalojnë përsëri te drejtësia këto para, apo shkojnë në sektor të tjerë?

Së dyti, marr shkas nga dëgjesa që bëmë sot me zotin Lleshaj, ideja është se vetë në buxhetin e Ministrisë së Brendshme, duke qenë se është edhe buxheti i prefekturave, ka pasur një fond të përcaktuar qartë për sa i takon Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë për Tokën Bujqësore, që janë struktura pranë prefekturave. Ato do të funksionojnë deri në fund të këtij viti. Në qoftë se mbani mend, ne e shtymë afatin e ligjit për verifikimin e titujve për tokën bujqësore

dhe nuk do të kenë mandat tej këtij viti. Dua të di: a është parashikuar kjo në buxhet, sepse nuk do të jenë më, se mos kemi një zë në lidhje me këtë çështje, e cila nuk është më e nevojshme? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Për reformën në drejtësi për vitin 2020, e kam thënë edhe gjatë këtyre ditëve, janë dhënë rreth 1,1 miliardë lekë; për reformën në drejtësi në nenin 11 kemi edhe 300 milionë lekë të tjerë në kuadrin e fondit rezervë për institucionet e tjera; për reformën në drejtësi, unë e kam thënë, ju nuk keni qenë këtu, por do të doja të kishit qenë këtu, sepse gjatë atyre 2 ditëve për mua si ekonomist, jo si jurist, ky është buxheti i reformës buxheti i reformës në drejtësi. Buxhet ka në çdo fushë, në arsim dhe shëndetësi ka më shumë, por buxheti i vitit 2020, me plot kuptimin e fjalës mund të quhet buxheti i reformës në drejtësi. Pse?! Sepse në këto momente të gjitha institucionet, që i kemi krijuar bashkërisht, janë të konsoliduara, kanë ardhur më të maturuara, kanë ardhur me shpenzime më ndryshe dhe të gjitha janë planifikuar, absolutisht nuk i mungon asgjë, madje 50 apo 60 veta, që ne krijojmë SPAK-un më 1 janar, i janë ulur Prokurorisë së Përgjithshme që të krijohet SPAK-u, por që fond rezervë ka edhe për këtë çështje. Ju, si juristë, e dini më mirë se unë që nga Prokuroria e Përgjithshme do të dalë ai buxhet. Pra, për mua, ky buxhet nuk ka asnjë lloj problemi. Te Ministria e Brendshme në projektbuxhet është kjo pikë, por kjo është e lidhur më tepër me Ministrinë e Drejtësisë. Ka disa institucione, të cilat kanë ndryshuar varësinë, për shembull, më parë ALUIZNI-n e ka pasur Ministria e Drejtësisë, por këtë vit ka ikur, nuk është më në evidencat e Ministrisë së Drejtësisë dhe ka kaluar si institucion në varësi të Këshillit të Ministrave. Po ta shikoni tabelën numër 1, të gjitha institucionet e reja janë krijuar me fondet përkatëse. Kështu që janë të detajuara, janë të sakta dhe nuk ka asnjë lloj problemi në këtë pikë.

Në përgjithësi, të tria institucioneve të vetingut që ishin këtu, pyetja kryesore që kryetari dhe ne u bëmë, por sidomos unë, lidhet me fondet financiare dhe funksionaliteti i institucionit nëse është 100% i realizueshëm në vitin 2020 dhe me gojën e tyre, me zë dhe figurë, ata thanë që po është. Çfarë kërkojnë ata në tërësi?! Ata nuk kërkojnë gjë për veten e tyre, zonja Klodi, fare, dhe kjo është absurdja që ne i kemi mësuar më keq se sa duhet, këtë e them unë, mos e thoni ju si juristë, por ne i mësuam më keq sesa duhet. Pra, ata nuk kërkojnë më gjë për veten e tyre, sepse i kanë marrë të gjitha dhe nuk kanë se çfarë marrin më, por ata kërkojnë për pastrueset, shoferët, ekonomistët, këshilltarët, pra për stafin ndihmës të tyre. Ata jo vetëm që marrin 80% të pagës që

e ka ligji, por kërkojnë edhe gjëra të tjera më shumë. Dakord, shumë mirë që i kërkon dhe ne jemi të detyruar t'i japim dhe jemi të detyruar ta njoftojmë qeverinë, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë të bëjë aktet nënligjore për nxjerrje, sepse nuk mund t'i japësh ti shpërblim. Për shembull, KPA-ja nuk mund të mbledhë kolegjin, për atë çfarë ne e kemi zgjedhur, dhe të thotë që unë do t'u jap këshilltarëve të mi 3 rroga shpërblim. Unë i thashë: “Ku e gjen këtë të drejtë ti, zonjë, të mbledhësh një trupë, të cilën ne e kemi votuar që të bëjë vetingun e prokurorëve dhe gjyqtarëve, dhe t'u thuash që ne do t'u japim nga tri rroga shpërblim këshilltarëve?! Këtë nuk e bëjmë ne këtu”.

Së dyti, unë i thashë asaj: “Ti e ke lënë institucionin dy muaj pa rrogë, sepse, padrejtësisht, ke marrë lekët e rrogave nga fondi i pagave dhe i ke dhënë për shpërblime. KLSH-ja ty të gjen në procedurë dhe të thotë që je në shkelje të hapur. Kush të tha ty që të japësh tri rroga?! Po sikur qeveria të marrë vendim dhe të thotë që dua t'u jap 5 rroga shpërblim? Po sikur qeveria të thotë që kam mundësi financiare që vitin tjetër t'u jap vetëm një rrogë shpërblim këshilltarëve? Do të thotë që ata duhet t'i kthejnë lekët mbrapsht, i thashë unë. Domethënë, ti ke bërë veprim të gabuar dhe nuk e ke të mbështetur diku, pa dalë akti nënligjor”. Pra, kanë ndërhyrë te buxheti, tek ana financiare, që edhe nuk e kuptojnë, padrejtësisht. Mua më duhet t'ju them juve si juristë, në Komision të Ligjeve dhe që keni qenë partizanë të kësaj reforme të drejtësisë, kam përshtypjen se këto struktura që janë krijuar po rendin për të përfituar dhe për të marrë sa më shumë lekë dhe nuk po bëjnë punën e tyre, për të cilën janë krijuar. Unë dua t'i kërkoj kryetarit të komisionit, duke marrë shkas nga pyetja që ju bëra, por edhe juve, që nga komisioni i famshëm, që kemi zgjedhur ne për monitorimin, duhet të kemi një informacion të hollësishëm në fund të muajit dhjetor dhe në fund të vitit 2019. Kjo në funksion edhe të faturës financiare që qeveria është treguar bujare, zemërgjerë dhe ka dhënë vazhdimisht. Sa herë që të vijnë dhe të kërkojnë ne duhet t'u themi: “Ma trego normën që ke bërë dhe çfarë ke realizuar”, sepse kam përshtypjen që nuk ecin në linja të barabarta ajo, nga pikëpamja profesionale e punës, dhe kjo nga pikëpamja financiare. A e dini se çfarë ka bërë KPA-ja, zonja Klodi, që është shkelje skandaloze?! Si mund të hapësh ti një procedurë me tender për të bërë sigurimin e jetës dhe sigurimin e shtëpisë me buxhetin e shtetit dhe me lekët e taksapaguesve shqiptarë?! Pse nuk e bën edhe ti, si deputete, që je një personalitet, apo unë, në raport me atë kryetare dhe me atë grup gjyqtarësh, sigurimin e jetës dhe të shtëpisë me lekët e buxhetit të shtetit?! Ti mund ta bësh me fondin tënd të pagave, por jo me lekët e buxhetit të shtetit. A e kuptoni se ku arrijnë?! Unë e kam thënë para dy ditësh, por ju nuk keni qenë, që do

t'i drejtohem me një shkresë, si relator, kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili automatikisht, me kërkesën time, duhet të ngrejë një grup pune për të bërë një kontroll në të tria komisionet e vetingut për çështjet financiare, për të kontrolluar buxhetin e shtetit dhe të gjitha aktet nënligjore që ne kemi nxjerrë, nëse janë zbatuar, janë trajtuar, si i kanë marrë, si i kanë përdorur këto fonde dhe në qoftë se gjejnë shkelje, t'i vënë njerëzit përpara përgjegjësisë dhe të kthejnë paratë, sepse janë paratë e shqiptarëve.

Ulsi Manja- Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Faleminderit, zoti Fino, dhe urime për relacionin që keni bërë!

Bashkohem me vlerësimin që bëri kolegja Bushka, që është një relacion i detajuar dhe u jep zgjidhje pyetjeve dhe çështjeve.

Unë vlerësoj tri institucione të rëndësishme, të cilat ju i keni analizuar: projektbuxhetin e Avokatit të Popullit, që është institucion i rëndësishëm, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kam një pyetje për Ministrinë e Drejtësisë. Nga seancat dëgjimore që kemi zhvilluar në Komisionin e Ligjeve dhe Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut ka rezultuar që ende nuk ka filluar zbatimin e ligjit të ndihmës juridike dhe për buxhetimin. A e vlerësoni se ka nevojë për një buxhetim më të mirë të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, sepse këtu shoh që thuhet se nuk ka kërkesë?

Së dyti, zoti Fino, unë kam një pyetje për ju, meqenëse jeni i fushës në çështjet e qeverisjes vendore. Me kaq shumë ligje sa kemi miratuar dhe për të cilat ju keni ngritur me të drejtë shpesh zërin, duke u shtuar kompetenca organeve të qeverisjes vendore, në nenin 11 të projektligjit për buxhetin e shtetit thuhet që në vitin 2020 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësisë të qeverisjes vendore me efekte financiare, ndërkohë që ne kemi bërë ndryshime dhe kemi kërkuar që ata të ngrenë mekanizmin e referimit të dhunës në familje, mekanizmin për trajtimin e fëmijëve ose kompetencat në lidhje me ligjin për diasporën. Në seancën dëgjimore që bëri ministri i Shtetit për Diasporën në Komisionin e Politikës së Jashtme ai tha që bashkitë e mëdha kanë nevojë për një strukturë të dedikuar për çështjet e diasporës, por në raport shoh që nuk ka propozime për shtesë, për kërkesë apo për përmbushje të këtyre tri fushave për të cilat ne kemi detyrime t'i përmbushim në vitin 2020. Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Hysi!

Bashkim Fino- Për tria institucionet: Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale ne kemi pasur bonsensin dhe për ato çfarë kanë kërkuar ne ua kemi zgjidhur. Avokatja e Popullit nuk ishte prezent, ishin dy komisionerë dhe financieri dhe ne e vlerësua që zëri i investimeve të shtohet dhe ju e keni një material që nga 2 milionë të bëhet 4 milionë. Pra, i dhamë Avokatit të Popullit, edhe pa qenë prezent, ishim shumë zemërgjerë dhe me argumentet që bëmë thamë që duhet rritur ky investim, madje i shtuam edhe zërin e mallrave dhe shërbimeve që nga 14,9 që ishte të bëhet 16,5, aq sa ishte në vitin 2019. E gjithë problematika tjetër ka të bëjë me pagën e komisionerëve, e cila është një çështje që e ngritën organet e vetingut dhe ka të bëjë me vjetërsinë, me shërbimin dhe me vështirësinë në punë, që është nenin 29, pika 5 e ligjit organik duhet të ketë një udhëzim dhe një VKM nga qeveria që përfshin edhe këta. Fatkeqësia jonë, edhe juaja. zonja Vasilika, pavarësisht se ju jeni nënkryetare e Kuvendit dhe trajtoresh pak më mirë se deputetët e tjerë, është se një komisioner i thjeshtë i Avokatit të Popullit merr dyfishin e rrogës tënde dhe merr dyfishin e benefiteve që merr ti si nënkryetare e Kuvendit. Ata kishin ardhur këtu që të kërkonin këtë gjë, pra pagën e tyre personale dhe nuk erdhën të kërkonin ndonjë investim apo të hapnin zyra të Avokatit të Popullit në organet e qeverisjes vendore, megjithatë, prapë ne i dëgjua dhe i dhamë Avokatit të Popullit 2 milionë shtesë investime, i kemi dhënë 16,5 milionë shpenzime mallra, pra nga 14 ua bëmë 16 dhe u thamë që në momentin që do të dalë akti nënligjor i qeverisë do të trajtoheni edhe ju, pavarësisht me zemër të thyer, me atë pagë që ju takon për të trajtuar, sepse ti e di që Avokatja e Popullit merr pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ata marrin 80% të pagës së Avokatit të Popullit e kështu me radhë shkon zinxhir kjo gjë.

Së dyti, me Komisionerin për Diskriminimin nuk kishte asnjë lloj problemi, ishin të gjithë zërat në rregull, por të vetmin problem që kishte Komisioneri për Diskriminimin ishte një investim për të ndihmuar, që ti e ke merak shumë, njerëzit në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuar për të hipur në zyrat e tyre. Ka filluar procesi i tenderimit, por kishin merakun se, meqenëse është fund nëntori, mos ua kthente APP-ja dhe mund t'u digjej fondi, dhe ne i thamë që në këtë moment që ti ke ardhur për buxhetin e vitit 2020 ne nuk mund t'i themi që po t'u dogj ky fond ta japim në vitin 2020, por unë i thashë të sugjeroj që t'i ta përdorësh këtë fond tani, mundohu ta mbyllësh me letra, ta bësh këtë investim brenda këtij viti, të fitosh një investim tjetër në vitin 2020 dhe mos të rifitosh të njëjtin investim të vitit 2019. Unë jam gati dhe i kërkoj komisionit përgjegjës që, nëse procedura e prokurimit për realizimin e këtij investimi të filluar nuk arrihet të përballohet nga buxheti i këtij

viti, të parashikohet si akordim i projektbuxhetit të vitit 2020. Pra, ne, si komision, kemi prapë bonsens të gjerë dhe i themi që bën mirë ta realizosh tani investimin. Po kështu edhe Komisioneri për të Drejtat e Informimit çdo vit na ka marrë diçka, edhe këtë radhë, me ndihmën e kryetarit të komisionit mori diçka, nga 37 i bëri 40 punonjës, që nuk mund të shtojmë më, sepse, zonja Vasilika, të gjithë komisionerët kanë 31 dhe 35 punonjës.

Kalojmë te pyetja e pushtetit lokal. Zonja Hysi, sa i takon ndihmës juridike, që ju e keni me shumë qejf, Ministria e Drejtësisë erdhi t'ju raportojë, ishte shumë serioze dhe e kënaqur me projektbuxhetin, sepse jo çdo ministër është i kënaqur me buxhetin, pasi sa më shumë t'i japësh, aq më shumë duhet dhe për këtë duhet të jesh e bindur, por, gjithsesi, në pasqyrën 1 të buxhetit është parashikuar ndihmë juridike 76 milionë lekë, pra janë të parashikuara dhe nuk kanë asnjë lloj problemi.

Kalojmë te problemi që ka pushteti vendor. Duhet të keni parasysh që ka një tabelë të numrit të punonjësve në Republikën e Shqipërisë, që fillon nga Presidenti i vendit deri te më i ulëti. Kjo tabelë ka 82377 punonjës dhe, zonja Vasilika, në këtë tabelë nuk përfshihet pushteti vendor, por është administrata e lartë shtetërore, ku përfshihen Kuvendi, Presidenca, Kryeministria, ministrinë përkatëse, KLSH-ja, Gjykata Kushtetuese, ATSH-ja, KLP, SPAK-u, Instituti i Statistikave, Shkolla e Magjistraturës e të tjerë, si dhe agjencitë që janë në varësi të qeverisë deri tek Autoriteti i të Drejtës për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Pra, janë 82377 punonjës për vitin 2020. Në këtë listë...

Ulsi Manja- Pa u përfshirë pushteti vendor?

Bashkim Fino- Nuk përfshihet pushteti vendor.

Ulsi Manja – Sa shkon bashkë me pushtetin vendor?

Bashkim Fino – Pushteti vendor ka strukturën e vet, ta realizojë me strukturën tip. Me këtë dua të them që ky buxhet nuk i pezullon detyrat e reja që me ligj pushteti vendor ka për detyrë t'i respektojë. Në qoftë se ne i themi me ligj që do të ngresh një zyrë për diasporën, ai do ta ngrejë. Në qoftë se ne i themi me ligj që do të kesh këto probleme që folëm sot me Ministrinë e Brendshme, ai do t'i trajtojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Vasilika, duhet të kuptoni një gjë: që neni 11 flet për numrin e përgjithshëm të punonjësve në organikë, që është 82377, ku thotë: “Në këtë numër, 82377, dhe në rezervën e pozicioneve të qeverisjes qendrore janë edhe 110 vende rezervë.”. Pra, unë them që shteti ynë do

të ketë 82377 punonjës dhe përveç kësaj gjatë vitit 2020 do të ketë edhe 110 vende vakante, që, në qoftë se parashikohen institucione të reja qendrore, ose agjenci të reja, do të preket numri 110. Neni 11 thotë që numri 110 nuk preket për pushtetin vendor, që do të thotë se për vitin 2020 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturën organike të njësive të qeverisjes vendore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Pra, në qoftë se ti krijon një agjenci të re, numri i punonjësve nuk merret nga numri 110. Domethënë, pushtetin lokal mund ta krijosh vetë, por unë nuk të jap gjë nga pushteti qendror. Ky numër nuk ka të bëjë me pushtetin vendor, sepse ato pothuajse, e kanë bërë, ligji i diasporës ka hyrë në fuqi dhe ata i kanë krijuar zyrat përkatëse. Kjo është një çështje që ka të bëjë midis pushtetit qendror dhe lokal dhe i thotë që unë nuk të miratoj asnjë ndryshim në strukturën organizative të njësisë së qeverisjes vendore për efekte financiare.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Me sa duket nuk ka, sepse relacioni i zotit Fino është shterues, madje po përdor edhe një fjalë që Bashkimi e përdori gjatë këtyre ditëve, ishte shkatërrues si relacion.

Në fakt, mua nuk më mbetet gjë tjetër vetëm ta hedhim në votim raportin e Komisionit të Ligjeve për projektbuxhetin e vitit 2020 dhe pastaj të kalojmë në votimin nen për nen të projektbuxhetit për vitin 2020, pjesë e të cilit do të jetë edhe raporti që do të miratojmë.

Zoti Fino, e hedhim në votim.

Kush është dakord me raportin e komisionit? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet raporti i Komisionit të Ligjeve për projektbuxhetin e vitit 2020.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020, pjesë e të cilit në nenet përkatëse është bashkëngjitur edhe raporti që sapo miratuam. Pra, Komisionit përgjegjës për Financat dhe Ekonominë do t’i shkojë projektligji “Për buxhetin e vitit 2020”, që do të miratojmë në komision, bashkëngjitur me raportin që sapo votuam.

Zoti Fino, po më ndjek?

Kalojmë te neni 1. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Neni 3 deri te neni 7 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Kalojmë te kreu II, “Burimet për mbështetjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit”. Ky kre fillon me nenin 8.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu III, “Shpenzimet e buxhetit të shtetit”. Ky kre fillon me nenin 10.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Po bëj një sqarim, më tepër për kolegët.

Ju rekomandoj ta votoni siç është, pavarësisht luftës që kam bërë vitin e kaluar dhe sivjet, që ky nen bie ndesh me rreth 790 gjyqtarë e prokurorë, që marrin një pagë më të lartë. Nuk jam kundër pagës më të lartë të tyre, sepse ne e kemi votuar atë, por ky nen duhet rikonceptuar dhe duhet ndryshuar.

Do të mundohem të bëj një diskutim sa politik, aq edhe profesional në datën 5 dhjetor. Ju rekomandoj ta dëgjoni. Personalisht (nuk dua t’ju imponoj si komision), kam të drejtën të bëj një amendament të këtij neni, sepse nuk shkon kështu. Ne miratojmë pagën më të lartë në Shqipëri, por paga më e lartë në Shqipëri nuk është 257-ta e Presidentit. Paga më e lartë në Shqipëri është kjo që kam nxjerrë në listë, duke filluar nga kryetari i Gjykatës së Lartë me 326 mijë lekë të rinj e duke përfunduar te gjyqtari i Shkallës së Parë në Tiranë, që merr 265 mijë lekë të rinj, pra më shumë se ky, duke vazhduar me komisionerët e Avokatit të Popullit dhe me disa institucione, si KLSH-ja e të tjera me statusin si anëtarë të Gjykatës së Lartë.

Do të dëgjoni edhe xhevahire të tjera, zoti kryetar. Ka edhe disa institucione të tjera, që janë agjenci dhe janë jashtë tabelës së pagave të shtetit shqiptar, por që emërohen nga Kryeministri, nga ne, dhe marrin nga 3,4 deri në 8 milionë lekë. Do të dëgjoni vërtet xhevahire shumë interesante kur të vijë puna për të treguar se sa paga marrin.

Gjithsesi, për këtë nen do të abstenoj, sepse kam bërë një amendament.

Nëse doni ta dëgjoni amendamentin e nenit 12, po jua them, se mbase mund të më mbështesni kur të vijë puna për ta votuar dhe është normale të bëhet kështu.

Për mua, neni 12 duhet të jetë i formuluar kështu: “Paga e Presidentit të Republikës është 257 mijë lekë në muaj. Është paga më e lartë në administratën publike për vitin 2020. Përjashtim nga ky përcaktim bëjnë punonjësit që kanë statusin e magjistratit dhe anëtarët e institucioneve të rivlerësimit kalimtar të figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.” Pra, ne duhet ta bëjmë këtë përjashtim, sepse këta janë një grup prej 700-800 vetash, të cilët marrin më shumë se Presidenti. Në nenin 12 duhet të themi: “Kjo është paga më e lartë”. Pra, mbi pagën e Presidentit do të referohet gjithë administrata, duke mos i marrë në konsideratë ata që me ligj u kemi dhënë të drejtën të marrin më shumë pagë. Kjo është mëse normale të bëhet, pavarësisht se ka edhe shumë xhevahire të tjera, që ju rekomandoj t’i dëgjoni në diskutimin që do të bëj, sepse do t’ju bëjnë mirë. Pastaj do të jap në të gjitha...

Ulsi Manja – Unë mendoj se amendamenti...

Bashkim Fino – Gjithsesi, nuk ju imponoj. Unë do ta abstenoj këtë nen, sepse do të bëj ndryshim për të.

Ulsi Manja – Zoti Fino, mendoj se amendamenti juaj për nenin 12 do të na hapte rrugën të rishikonim edhe pagat e organeve që kanë si pagë reference sistemin e drejtësisë. Ne e kemi diskutuar dhe janë shumë institucione kushtetuese ose të krijuara me ligj, që në statusin e trajtimit financiar janë barazuar me anëtarët e Gjykatës së Lartë ose të Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjë nuk është e drejtë, sepse këtë përjashtim ligjvënësi e ka bërë vetëm për sistemin e drejtësisë. Ndoshta amendamenti juaj në nenin 12 do të na hapte rrugën që në një të ardhme të shpejtë të rishikojmë gjithë tabelën e pagave për institucionet e tjera, që kanë si pagë reference anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithsesi, e hedh në votim nenin 12 në këtë variant, siç e kemi, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nga zoti Fino.

Miratohet neni 12.

Kalojmë te neni 13. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Neni 14 deri te neni 20 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Neni 21, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për buxhetin e shtetit për vitin 2020”.

Ky projektligj, që sapo e miratuam, bashkëngjitur me raportin që votuam pak më parë, që reflekton propozimet tona për ndryshim në zëra të caktuar të këtij projektligji, t’i përcillet Komisionit përgjëgjës për Financat dhe Ekonominë e më pas seancës plenare!

Më lejoni, të nderuar kolegë, që në përfundim të këtyre 4 ditëve të shqyrtimit dhe diskutimit të buxhetit, të bëj disa falënderime, në radhë të parë, për relatorin, zotin Fino, por edhe për stafin e këshilltarëve që e kanë asistuar zotin Fino gjatë këtyre ditëve, duke filluar me Isidën, Ivën, si dhe me këshilltarët e drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, që kanë qenë përgjëgjës në mbajtjen shënim dhe të diskutimit të buxhetit për rreth 11 institucione kushtetuese dhe të krijuara më ligj, që monitorohen nga ky shërbim!

Dua të falënderoj gjithë kolegët e mi deputetë për impenjimin gjatë këtyre ditëve dhe për durimin që kanë treguar në shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit!

Dua të falënderoj mediet, që e kanë transmetuar me shumë korrektesë gjithë diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2020!

Falënderoj gjithë të pranishmit!

Nuk mund të lë pa falënderuar edhe këshilltarët e Komisionit të Ligjeve, Edlirën, por edhe Evin, për gatishmërinë dhe korrektësinë që kanë treguar!

Edhe një herë, shumë faleminderit, kolegë! Ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino -... mbledhjen.

Duke ju falënderuar edhe ju në emër të tyre, kam vetëm një merak, zoti kryetar. Do të doja impenjimin tuaj, impenjimin e zonjës Vasilika dhe impenjimin e çdo anëtarit të këtij komisioni të nderuar (impenjimin timin patjetër që do ta keni, nuk diskutohet), që, këto që i punuam 4-5 ditë me seriozitet, të merren në konsideratë (se janë gjëra shumë të vogla) nga Komisioni i Ekonomisë. Në të kundërt, në qoftë se nuk merren në konsideratë, do të të lutesha, si kryetar komisioni, të na

vësh në dispozicion (se ty të lidh puna me Konferencën e Kryetarëve) se cili nen nuk u mor në konsideratë, se cili institucion nuk u mor në... Se mund të na ndodhë (ishalla nuk ndodh) që këtu i thamë institucionit se kërkon shumë gjëra, këtë nuk ta bëjmë dot dhe nuk e morëm në konsideratë, dhe në qoftë se merret në konsideratë kjo do të thotë se nuk pyetet fare ky komision. Unë do të doja transparencë nga ju, si kryetar i komisionit. Jeni ju ai që na përfaqësoni në raport me komisionet e tjera dhe në Konferencën e Kryetarëve.

Si relator, e kërkoj këtë personalisht, pastaj do t'ua vë në dispozicion dhe kolegëve. Dua informacionin përfundimtar, të cilin di ta lexoj vetë dhe nuk ma hedh dot njeri. Ti vetëm kaq më thuaj. Unë di ta lexoj vetë në buxhetin që do të nxjerrin përfundimisht ata, nëse u morën apo nuk u morën në konsideratë këto, apo mund të merren gjëra të tjera plus, ku mund të punohet *underground* për të përfituar ndonjë gjë tjetër. Kjo është shumë diskriminuese për mua si relator, por edhe për ju si kryetar komisioni. Këtë e kërkoj nga ju. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit për sugjerimin, zoti Fino!

Në përgjigje të kësaj që sapo tha zoti Fino, kam patur sot një takim me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si dhe me kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Ju garantoj, zoti Fino, që për raportin, të cilin sapo e miratuam dhe projektligjin, që sapo e votuam në komision, si kryetar komisioni dhe ju si relator, do të jemi bashkë për ta mbrojtur deri në fund. Një gjë është e sigurt: asgjë tjetër jashtë këtij raporti, që sapo e votuam në komision, nuk do të lejojmë të ketë. Gjithsesi, ne do të jemi bashkë për ta bërë edhe këtë takim para se të votohet në seancën plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA